



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 21.07.20 Ref.: 976/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet Kolegji Pjetër Budi në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të kolegjit Pjetër Budi për vitin akademik 2020 – 2021 deri në periudhën tjetër të riakreditimit institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji Pjetër Budi ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Kolegjin Pjetër Budi më datë 16.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Melita Kovacevic, Magdalena Platis dhe Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Pjetër Budi dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji Pjetër Budi nga gjithsej 11 kapituj të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit i përmbush standardet si vijon: i përmbush substancialisht dy (2) kapituj (Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Burimet dhe hapësirat), i përmbush pjesërisht pesë (5) kapituj (Planifikimi strategjik; Planifikimi dhe menaxhimi financiar; Integriteti akademik; Mësimdhënia dhe të nxënit; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse), dhe nuk i përmbush katër (4) kapituj (Misioni publik dhe objektivat institucionale, Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi dhe Bashkëpunimi institucional).

Në raportin e ekspertëve, disa herë është cekur se kolegji Pjetër Budi nuk ka ofruar dokumente shitesë në gjuhën angleze në fillim, por edhe në dokumente të ndryshme gjatë vlerësimit, disa pjesë nuk kanë qenë në gjuhën angleze, dhe kjo lë përshtypjen se institucioni nuk ka qenë mjaft i përkushtuar e as i përgatitur për vlerësim.

Gjatë vlerësimit, ekipi i eksperteve ka identifikuar disa kapituj të cilët kanë rezultuar në rekomandim negativ, mbi bazën e Manualit të AKA-së. Kapitujt të cilët Kolegji Pjetër Budi ka dështuar të përmbushë janë:

Kapitulli i parë (Misioni publik dhe objektivat institucionale / Nuk përmbushet), ekspertët vlerësojnë se misioni i kolegjit nuk është dhënë në mënyrë të qartë, sepse shtylla e tretë është e përkufizuar në mënyra të ndryshme në dokumente të ndryshme përfshirë këtu raportin e vetëvlerësimit. Megjithëse është dhënë një deklaratë e shkurtër për proces të konsultimit në të cilin janë përfshirë palët e jashtme dhe të brendshme të interesit, nuk ka informata lidhur me procesin se çfarë lloj konsultime janë bërë, kush saktësisht ka marrë pjesë, etj. Ekspertët nuk kanë arritur të nxjerrin asnjë informatë relevante në këtë drejtim gjatë intervistave, sepse përgjigjet kanë qenë të mangëta. Objektivat nuk janë mirë të përkufizuara, dhe nuk janë formuluar në mënyrë logjike, kalojnë nga një fushë në tjetrën dhe nuk korrespondojnë plotësisht me misionin, si dhe nuk janë të paraqitura si objektiva afatmesme dhe afatgjate.

Një mision i tillë dhe objektivat e tilla shoqëruese nuk mund të ofrojnë një udhëzues efektiv për planifikim strategjik, si dhe për efikasitet në vendimmarrje dhe funksionim të përgjithshëm institucional. Ekspertët rekomandojnë se është me rëndësi që misioni i kolegjit të ri-definohet në mënyrë të qartë, bazuar në tri shtyllat, gjë që do të profilizonte institucionin në mënyrë optimale, si dhe të zbatohen procedura të përshtatshme dhe të merren parasysh perspektivat e palëve të ndryshme të interesit.

Kapitulli i dytë (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi / Përmbushet pjesërisht): Sipas ekspertëve, plani strategjik ekzistues i kolegjit, nuk është në përputhje me proceset buxhetore dhe nuk është e qartë se si do të përshtatet në rast nevojë. Sipas disa shembujve të përmendur në raport, ekspertët konstatojnë se kolegji nuk është mirë i informuar dhe i përfshirë në të gjitha proceset relevante akademike, dhe si i tillë nuk është në gjendje të kryejë detyrat përkatëse. Planin strategjik përfundimisht nuk përfshin të gjitha aspektet e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Edhe pse raporti i referohet kontekstit të shtetit, dhe pretendon se përqendrohet në përmirësimin e tregut të punës, ai nuk është aspak realist kur synon përsosmëri në mësimdhënie, hulumtim dhe inovacion, duke treguar një nivel shumë të ulët të vetëdijes institucionale dhe njohjes së aftësive të veta. Shumë paqartësi ka po ashtu edhe në përshkrimin e roleve të organeve drejtuese dhe atyre menaxheriale, si dhe organeve drejtuese

akademike, ku theksohet se rektori përmendet pak dhe nuk janë të qarta roli dhe përgjegjësitë e tij si dhe të zëvendësrektorëve. Ekspertët pas intervistave kërkuar sqarime për këtë çështje, sidomos për shkak të mungesës së informatave në gjuhën angleze, mirëpo edhe ato përgjigje që i ofroi kolegji nuk ishin të kënaqshme. Sa i përket përzgjedhjes së studentëve në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe këshilluese, ekspertët shprehin rezervë se këto organe janë me të vërtetë funksionale.

Kapitulli i tretë (Planifikimi dhe menaxhimi financiar / Përbushet pjesërisht): Kolegji ka ofruar shumë dokumente në gjuhën shqipe për planifikim dhe menaxhim financiar, mes tjerash tabelën për buxhetin 2020-2025, si dhe vitet akademike 2020/21-2024/25, dhe nuk ka as komente as sqarime për buxhetin të integruara në RVV. Janë paraqitur edhe të ashtuquajtura strategji, të cilat në fakt as nuk janë strategji por deklarata të thjeshta qëllimi pa asnjë dëshmi të qartë të burimeve të të ardhurave dhe mundësive të rritjes dhe diversifikimit të të ardhurave. Nga të gjitha të dhënat për buxhetin, kolegji nuk mund të dëshmojë se ka burime të mjaftueshme financiare që ti adresohet në mënyrë efektive misionit të tij, si dhe objektivave të përcaktuara në planin strategjik, në aspektin afat shkurtër ose afat mesëm. Kolegji nuk ka ndonjë rregullore mbi stabilitetin financiar, dhe ekspertët konsiderojnë se nuk ka buxhet realist dhe nuk ka përpunuar asnjë politikë financiare që adreson qëndrueshmërinë e saj financiare.

Kapitulli i katërt (Integriteti akademik / Përbushet pjesërisht): Kolegji e ka kodin e etikës, por nuk e ka dorëzuar së bashku me RVV, si dhe në ditën e vizitës nuk ka qenë në ueb faqen e kolegjit. Pas kërkesës së ekspertëve, kolegji e ka dërguar atë dokument, dhe vlerësimi i ekspertëve është se ai është vetëm si një dokument i cili duhet vetëm të figurojë patjetër, e jo si domosdoshmëri për përcaktimin e parimeve të integritetit brenda kolegjit dhe mes anëtarëve të komunitetit akademik. Në strategjinë e miratuar rishtazi për kërkime për periudhën e vitit 2019- 2024, megjithëse ekzistojnë disa standarde shkencore, asnjëri prej tyre nuk përmend çështjet etike.

Dokumentet që përshkruajnë shtjellimin e tezës si për nivelin bachelor ashtu edhe atë master nuk tregojnë qartë detyrimet e studentëve për sa i përket plagjiaturave. Ekspertët konsiderojnë se Kodi i etikës duhet të zbatohet qartë në të gjitha proceset dhe mekanizmat e brendshëm dhe se kolegjit i duhet shumë punë për këto çështje. Shumë rregullore, procedura, raporte të vetëvlerësimit dhe vendime të organeve qeverisëse nuk janë në dispozicion për publikun. Statuti i kolegjit figuron vetëm si ekzistues. Sa i përket mënyrës së informimit, ekspertët vlerësojnë se kolegji nuk ofron informacione të mjaftueshme të sakta, objektive e të rëndësishme si për studentët ashtu edhe për të gjitha palët tjera të interesit.

Kapitulli i pestë (5) (Menaxhimi i cilësisë / Nuk përbushet): Ekspertët nuk kanë gjetur asnjë provë që kolegji zhvillon sistemin e vet të sigurimit të cilësisë në mënyrë që të ruajë cilësinë e operacioneve të tij. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë nuk është i integruar në aktivitetet e përditshme të kolegjit, përkundrazi duket se ai është paraqitur në atë mënyrë që të përbushë standardet e AKA-së. Prandaj, nga këndvështrimi i ekspertëve, ka më shumë punë për të bërë nga autoritetet e kolegjit dhe stafi kanë më shumë punë për të bërë që të arrihet një ekuilibër më i mirë midis sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë. Në përgjithësi, nuk ka asnjë dëshmi të një sistemi funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë me analiza periodike në të gjitha nivelet e kolegjit dhe raporte vjetore të vetëvlerësimit, analiza dhe plane veprimi për të përmirësuar dobësitë. Nuk ka menaxhim sistematik të cilësisë së ndonjë fushe institucionale - planifikim strategjik, menaxhim të burimeve njerëzore, programe studimi, etj., siç tregohet në fushat e tjera të raportit.

Kapitulli i gjashtë (6) (Mësimdhënia dhe të nxënit / Përmbushet pjesërisht): Sipas ekspertëve, kolegji ka hartuar disa politika, por të gjitha ato duken sikur nuk janë të plota. Rregullorja ekzistuese është vetëm për studimet master, e jo për ato bachelor, dhe është mjaft e vjetër, e pa azhurnuar që nga 2014, e ngjashëm edhe rregullorja për organizimin e provimeve dhe vlerësimin e studentëve. Është vërejtur se institucioni është i koncentruar vetëm te programi Doganë dhe Transport BA, mirëpo kolegji ka edhe programe tjera, dhe duhet të ndërmerr veprime për të siguruar që të gjitha programet të plotësojnë standardet e kërkuara të performancës. Prandaj, ekspertët konsiderojnë se nuk ka prova të qarta që institucioni menaxhon një sistem efektiv për të siguruar që të gjitha programet të plotësojnë standarde të larta të mësimin dhe mësimdhënies, duke filluar nga miratimet fillestare, ndryshimet e rregullta dhe monitorimi i performancës.

Institucioni nuk ka siguruar prova të qarta që kolegji vlerëson efektivitetin e programeve përmes të diplomuarve dhe anketimit të punëdhënësve.


Kapitulli i shtatë (7) (Hulumtimi / Nuk përmbushet): Ekspertët vlerësojnë se plani zhvillimor i hulumtimit i kolegjit Pjeter Budi nuk është dhe nuk mund të jetë në përputhje me natyrën dhe misionin e institucionit sepse vetë misioni nuk është i përcaktuar mirë dhe nuk reflekton dhe nuk përshtatet në kontekstin aktual vendor dhe rajonal. Planin nuk përfshin asnjë tregues, ai nuk është i matshëm dhe nuk është e mundur të monitorohet zbatimi dhe zhvillimi i tij. Në disa raste, kur renditen objektivat, ekziston një person/përgjegjës, për disa objektiva asnjë, me fjalë të tjera është vërejtur mospërputhje e cila sigurisht nuk kontribuon në përmbushjen e objektivave. Buxheti nuk është transparent për sa i përket ndarjes së një pjese të buxhetit për kryerjen e një studimi, dhe në të vërtetë nuk parashikon ndonjë plan të mirëfilltë të hulumtimit. Institucioni nuk ka kritere të qarta për vërtetimin e kërkimit, gjithçka mund të pranohej si një rezultat studimi, pavarësisht nëse është një abstrakt, një punim i botuar në një ditar që nuk njihet ndërkombëtarisht, në libër etj. Produktiviteti i përgjithshëm i hulumtimit është larg minimumit të kërkuar. Kriteret e promovimit janë jashtëzakonisht të paqarta dhe jo transparente, ato nuk reflektojnë aspak ambicie të institucionit i cili pretendon se një përsosmëri në kërkime dhe inovacion është një nga qëllimet e tij strategjike.

Kapitulli i nëntë (9) (Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse / Përmbushet pjesërisht): Edhe pse programi i orientimit paraqitet si një nga rekomandimet e mëparshme të arritura, ekspertët nuk kanë identifikuar ndonjë program të qartë orientimi për studentët e rinj. Të gjitha informacionet e nevojshme jepen nga Zyra e Shërbimeve Studentore. Sipas informacioneve të ofruara, ekzistojnë procese për të mbledhur të dhëna që i referohen progresit të studentëve dhe niveleve të braktisjes, kënaqësinë e studentëve me programet e tyre, burimet e të mësuarit dhe administratën dhe shërbimet mbështetëse, por ekspertët nuk kanë gjetur prova të qarta që të dhënat përdoren për të mbështetur vendimmarrjen në të gjitha nivelet e kolegjit: mësimdhënie, hulumtim ose administratë. RVV nuk ka ndonjë analizë konkrete dhe ndonjë plan zyrtar me veprime specifike. Në të gjitha rastet, nuk ka përdorim koherent të të dhënave për të mbështetur vendimmarrjen.

Kapitulli i njëmbëdhjetë (11) (Bashkëpunimi institucional / Nuk përmbushet): Sipas ekspertëve, ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi nuk duket se kanë qenë përparësi në Strategjinë e Kolegjit. Institucioni nuk ka një strategji bashkëpunimi institucional ose ndërkombëtarizimi dhe askush nga

menaxhimi i kolegjit nuk është i mandatuar për nismat dhe rezultatet në këtë fushë. Si pasojë, ekspertët nuk kanë identifikuar ndonjë mekanizëm për të mbështetur bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, rrjetet ose organizatat e arsimit të lartë, apo numër të marrëveshjeve ose memorandumeve me ndonjë institucion të arsimit të lartë. Sa i përket marrëdhënieve me industrinë lokale dhe punëdhënësit për të ndihmuar në ofrimin e programeve (siç është angazhimi i studentëve në punë praktike ose punësim), ekspertët mund të konfirmojnë se gjatë vizitës kanë vërejtur se ekzistojnë pak bashkëpunime, si dhe ka shumë pak angazhim të punëdhënësit lokalë dhe anëtarët e profesioneve në punën e komisioneve ose njësive të tjera strukturore në krahasim me numrin e programeve të studimit dhe aktivitetet e tjera institucionale. Institucioni nuk ka krijuar zyrtarisht një Shoqatë të Alumni, por ekziston vetëm një rrjet jo formal Alumni.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Lubotiq
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Pjetër Budi
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.